

NDIKIMI I COVID-19 NË INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË DHE VENDET E BALLKANIT PERËNDIMOR



Hulumtim nga:

Besa Zogaj Gashi
Drejtoreshë Ekzekutive, IETL
(besa.zogaj@ietl-oek.com)

Viola Brahusi
Koordinatorë e projekteve, IETL
(viola.brahusi@ietl-oek.com)

Rreth IETL:

Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL) është organizatë e pavarur, jopartiake dhe jofitim-prurëse e themeluar nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), me seli në Prishtinë. Në përmbushjen e misionit të saj, Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë zhvillon hulumtime të besueshme me fokus në temat kryesore ekonomike në sektorin privat në Kosovë dhe i shfrytëzon rezultatet e hulumtimit për avokim, diskutim e debate publike për të ndikuar në krijimin e politikave më të mira për sektorin privat.

Dizajni dhe faqosja:

Norë Potera

Origjinali është shkruar në gjuhën shqipe.

Të drejtat e autorit ©2020 nga Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë (IETL) dhe Fondacioni Konrad Adenauer.

Qëndrimet e paraqitura në këtë punim nuk paraqesin domosdo qëndrimet e Fondacionit Konrad Adenauer.

Tabela e Përmbajtjes

Hyrje	1
1. Vështrimi i Përgjithshëm i Ndikimit të COVID-19 në Vendet e Ballkanit Perëndimor	3
1.1. Ndikimi i COVID-19 në Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Ballkanin Perëndimor	6
2. Vështrimi i Përgjithshëm i Ndikimit të COVID-19 në Kosovë	7
2.1. Ndikimi i COVID-19 në Investimet e Huaja Direkte (IHD) në Kosovë	9
3. Përfundime dhe Rekomandime	12
4. Literatura	14

Lista e Figurave

Figura 1: Zhvillimi rajonal në Ballkanin Perëndimor sipas BPV në vitin 2020 parashikohet të jetë ndërmjet -3.1 dhe 5.6 përqind (sipas dy skenarëve)	3
Figura 2: Zhvillimi rajonal i konsumit në Ballkanin Perëndimor i parashikuar në vitin 2020 sipas dy skenarëve (i shprehur në përqindje)	4
Figura 3: Zhvillimi rajonal i investimeve në Ballkanin Perëndimor i parashikuar në vitin 2020 sipas dy skenarëve (i shprehur në përqindje)	4
Figura 4: Zhvillimi rajonal i eksporteve në Ballkanin Perëndimor i parashikuar në vitin 2020 sipas dy skenarëve (i shprehur në përqindje)	5
Figura 5: Zhvillimi rajonal i importeve në Ballkanin Perëndimor i parashikuar në vitin 2020 sipas dy skenarëve (i shprehur në përqindje)	5

Lista e Tabelave

Tabela 1: Parashikimi për Kosovën 2020 (para dhe pas COVID-19)	7
Tabela 2: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme (Janar- Gusht viti 2019, 2020) i shprehur në Euro	9
Tabela 3: IHD-të në Kosovë sipas shteteve (për periudhën 2007 - Qershor 2020)	10
Tabela 4: Vlera e IHD-ve në Kosovë - sipas aktivitetit ekonomik për periudhën Janar – Korrik 2019 dhe Janar - Korrik 2020 (të shprehura në milion euro)	10
Tabela 5: Dërgesat e emigrantëve - sipas kanaleve të dërgimit për periudhën Janar – Korrik 2019 dhe Janar - Korrik 2020 (të shprehura në milion euro)	11

Lista e shkurtesave

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

BB - Banka Botërore

BE - Bashkimi Evropian

BP - Ballkani Perëndimorë

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

BPV - Bruto Produkti Vendor

CEFTA - Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore

FMN - Fondi Ndërkombëtar Monetar

GBB - Grupi i Bankës Botërore

IETL - Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë

IHD - Investimet e Huaja Direkte

KIE - Këshilli i Investitorëve të Evropës

KIESA - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

NVM - Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

OBZHE - Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

PBB - Prodhimi i Brendshëm Bruto

RCC - Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal

TEG - Grupi i Ekspertëve të Turizmit

T1 - Tremujori i parë

T2 - Tremujori i dytë

UNCTAD - Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin

Pandemia COVID-19 është definuar si krizë globale e shëndetit dhe sfida më e madhe me të cilën jemi përballur që nga Lufta e Dytë Botërore. Në mbarë botën, që nga 31 dhjetori 2019 deri kah fundi i muajit shtator 2020 numri i rasteve të prekure me Covid-19 i ka tejkaluar 32 milionë raste të konfirmuara, përfshirë 991,224 vdekje, të raportuara në Organizatën Botërore të Shëndetësisë (OBSh)¹. Duke pasur parasysh përhapjen e shpejtë të pandemisë, vendet në të gjithë botën kanë miratuar disa masa të shëndetit publik që synojnë të parandalojnë përhapjen e tij, duke përfshirë distancimin shoqëror dhe orare të kufizuara lëvizjesh e orë policore si preventive për t'u përballur me valën e pandemisë. Pandemia COVID-19 nuk rrezikon vetëm shëndetin tonë por ka goditur fuqishëm edhe ekonominë e çdo vendi, duke sjellë me vete tronditjen e tretë dhe më të madhe ekonomike e financiare të shekullit 21 (krizë më e madhe se ajo e 11 shtatorit dhe krizës globale financiare të vitit 2008). Frenimi i përhapjes së COVID-19 për t'i zvogëluar viktimat në njerëz, dëmet në ekonomi dhe marrja e masave për rimëkëmbje mbeten preokupimi themelor në planin global dhe atë nacional në secilin vend. Parashikimet e fundit të Fondi Monetare Ndërkombëtar (FMN), qershor 2020², krahasuar me muajin prill, flasin për një parashikim më të zymtë për ekonominë globale për shkak të së pasojave COVID-19, duke parashikuar një tkurrje të ekonomisë globale prej 4.9 përqind në 2020 dhe një rimëkëmbje më të ngadaltë në 2021. Ashpërsia e rënies ekonomike do të varet nga ecuria e pandemisë në muajt e ardhshëm (ku ndryshimi i motit dhe ardhja e vjeshtës mund të rrisë rastet e reja me koroanvirus) dhe nga shkalla në të cilën mund të normalizohet jeta ekonomike.

Kriza COVID-19 do të shkaktojë një rënie dramatike të IHD-ve, duke sjellë sfida më të mëdha në vendet në zhvillim³ përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor (BP). Sipas Raportit të Investimeve Botërore (2020)⁴, dhe Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD)⁵ këtë vit IHD në nivel global parashikohej të ulen me 40 përqind në krahasim me vitin 2019 për shkak të ndikimeve të recesionit ekonomik të shkaktuar nga pandemia e koronavirusit. Sipas raportit në fjalë, IHD globale nga 1,54 trilion dollarë që u regjistruan vitin e kaluar (2019) do të bien me 40 përqind në vitin 2020, duke rënë

kështu për herë të parë që nga 2005 nën 1 trilion dollarë. Investimet e huaja do të godasin më shumë vendet në zhvillim, veçanërisht në vendet në të cilat dominojnë investimet e orientuara drejt eksportit dhe të mallrave. Në fund të muajit Mars, FMN njoftoi se investitorët kishin hequr 83 miliardë dollarë nga vendet në zhvillim që nga fillimi i krizës COVID-19, kjo është shifra më e lartë që është regjistruar deri më sot në ekonominë botërore. Raporti vlerëson se investimet e lartpërmendura mund të bien me 5 deri 10 përqind edhe në 2021. Investimet do të fillojnë të rimëkëmben në 2022. Raporti i Investimeve Botërore, tani në vitin e tij të tridhjetë, mbështet politikëbërësit për të përfituar nga revolucioni i ri industrial dhe për të kapërcyer nacionalizmin ekonomik në rritje, duke rritur bashkëpunimin dhe promovimin e investimeve që kërkojnë qëndrueshmëri, ndërtimin e zinxhirëve rajonale të vlerës dhe hyrja në tregje të reja përmes platformave dixhitale.

Ky punim ka për qëllim t'i trajtojë ndikimin e COVID në treguesit ekonomik dhe IHD-të në vendet e Ballkanit Perëndimor, skenarët e mundshëm të zhvillimit të ngjarjeve dhe refleksionet e tyre në Kosovë. Këtij raporti i paraprinë publikimi i punimit nga IETL me titullin Investimet e Huaja Direkte në Kosovë, klima e investimeve, potenciali dhe barrierat⁶ i cili publikua në fund të vitit 2019 në të cilin ofrohen informacione të vlefshme lidhur me barrierat me të cilat janë përballur investitorët e huaj në Kosovë (IHD) edhe para COVID—19, reformat që duhet bërë qeveria në zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe tërheqjen e IHD. Gjithashtu këtij raporti hulumtues i paraprinë analizimi i të dhënave sekondare (dokumenteve, raporteve vendore e ndërkombëtare të FMN-së, Bankës Botërore (BB), Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), artikuj shkencorë e profesionalë, të dhënave statistikore). Me qëllim të begatimit të përmbajtës së raportit, analizimit të gjendjes ekzistuese së IHD-ve përballë pandemisë në Kosovë, Instituti IETL ka zhvilluar gjithashtu intervistë me udhëheqësit e KIESA-së⁷ dhe KIE-së⁸. Raporti synon të rekomandojë përmirësimin e politikave për t'i zvogëluar efektet negative, me përqendrim në ekonomi, që COVID-19 ka shkaktuar në Kosovë ngjashëm me rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Raporti gjithashtu ka synim nxitjen e një debati

¹OBSh, Sëmundja e Koronavirusit (COVID-19), Shtator 2020, <https://covid19.who.int/>.

²Fondi Monetare Ndërkombëtar (FMN), Qershor 2020.

³Ekonominë në zhvillim pritet të shohin rënien më të madhe të IHD-ve sepse ata mbështeten më shumë tek investimet në globale zinxhir vlerash (GVC) - industri intensive dhe nxjerrëse, të cilat janë goditur rëndë, dhe sepse ato nuk janë në gjendje të vendosin të njëjtat masa të mbështetjes ekonomike si ekonominë e zhvilluara.

⁴https://unctad.org/en/PublicationsLibrary/wir2020_en.pdf

⁵https://unctad.org/system/files/official-document/wir2020_en.pdf

⁶<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf>

⁷Kreshnik Thaqi - Udhëheqës i Sektorit për Promovim të Investimeve në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

⁸Emrush Ujakani - Drejtor Ekzekutiv në Këshillin e Investitorëve të Evropës (KIE)

domethënës dhe të paanshëm midis akterëve të interesuar lidhur me situatën aktuale shëndetësore dhe ekonomike në Kosovë dhe faktorët tjerë si niveli i ulët i besueshmërisë institucionale, pengesat fiskale, pengesat administrative, korrupsioni, ekonomia joformale vazhdojnë të jenë pengesa kryesore për të bërë biznes në Kosovë dhe kërcënojnë vazhdimisht mjedisin e biznesit për tërheqjen e IHD në Kosovë⁹. Raporti synon të nxisë debate domethënëse gjatë procesit të draftimit të strategjisë së re për rimëkëmbjen ekonomike afatmesme në periudhë 5 vjeçare e cila duhet të ketë objektiva të qarta zhvillimore dhe hapa konkret për stimulimin e investimeve të huaja, të cilat përsuan rënie të konsiderueshme edhe para pandemisë gjatë vitit 2018 dhe 2017, duke lënë Kosovën si një vend jo tërheqës për investime të huaja dhe larg tërheqjes së investimeve nga korporatat dhe markat e mëdha botërore.


⁹Investimet e Huaja Direkte në Kosovë, klima e investimeve, potenciali dhe barrierat, 2019, <https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf>

1. Vështrim i Përgjithshëm i Ndikimit të COVID-19 në Vendet e Ballkanit Perëndimor

Në vendet e Ballkanit Perëndimor (BP), aktiviteti ekonomik në vitin 2019 ka shënuar rritje prej 3.4 përqind, që përbën një rritje të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak 4.0 përqind (pra modeli i rritjes ekonomike të vendeve të BP ishte i brishtë edhe përpara fillimit të krizës). Ndërsa për vitin 2020, kryesisht si pasojë e krizës ekonomike dhe sociale të shkaktuar nga pandemia COVID-19, GBB ka parashikuar një rënie të Bruto Produktit Vendor (BPV) në vendet e BP me 3.1 përqind sipas skenarit bazë¹⁰ dhe skenarit negativ 5.6 përqind¹¹, por me diferenca thelbësore në gjashtë shtetet,

bazuar në strukturën ekonomike dhe dobësitë e tyre në periudhën e para krizës¹². Kosova, Mali i Zi dhe Shqipëria do të goditen me një rënie në përqindje më të madhe nga parashikimet para COVID-19 në vitin 2020. Ndërsa ekonomia e Bosnje e Hercegovinës, Serbisë dhe sidomos Maqedonisë së Veriut parashikohet të përjetojnë me pak rënie të BPV (shiko Figurën 1). Edhe burime të institucioneve tjera prestigjioze të të dhënave flasin për parashikimet të përafërta: si: FMN, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE, 2020).

Figura 1: Zhvillimi rajonal në Ballkanin Perëndimor sipas BPV në vitin 2020 parashikohet të jetë ndërmjet -3.1 dhe 5.6 përqind (sipas dy skenarëve)



Burimi: Përlllogaritje të stafit të Bankës Botërore¹³

Shënim: Për Ballkanin Perëndimor, rritja reale e BPV është mesatarja e ponderuar.

Meqenëse ndikimi negativ i pandemisë në vitin 2020 pritet të materializohet në rënie të konsumit; të investimeve private; importeve dhe eksporteve, në vazhdim të këtij kapitulli do ti diskutojmë ndaras ndikimin në këta tregues ekonomik (duke ju referuar të dhënave sipas skenarit bazë dhe skenarit negativ).

Konsumi, përbën peshën më të madhe në ekonomitë e vendeve të rajonit, me përfshirje më shumë se 60 përqind të rritjes ekonomike e cila vitet e fundit erdhi si rezultat i rritjes së shpenzimeve publike, politikave të veçanta të pagave si dhe rritjes gati dyshifrore në huamarrjen e familjeve (kredive konsumatorë) dhe remitancave.

Duke iu referuar Bankës Botërore, evidentohet fakti se konsumi sipas skenarit bazë parashikohet

të ketë rënie në 1.7 përqind, ndërsa skenarit negativ 2.8 përqind në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2020¹⁴, ku Mali i Zi ka rënie më të madhe me 3.6 përqind sipas skenarit bazë dhe skenarit negativ 4.8 përqind. Faktorët të cilët ndikuan në rënie e konsumit janë rritja e papunësisë; rënia e të ardhurave familjare; përkeqësimi i situatës financiare të bizneseve, rënia e remitancave, të cilat parashikohet të bien me 10 pikë përqindje (pp) nga viti në vit në rajon, ku Serbia dhe Mali i Zi ka të ngjarë të pësojnë rënie prej gati 20 përqind. Konsumi publik në vendet e rajonit pritet të mbështesë kërkesën agregate, por në masë të pamjaftueshme për të kompensuar tkurrjen e komponentëve të tjerë, (për më shumë shiko Figurën 2).

¹⁰Skenari bazë supozon se përhapja e pandemisë në Evropë fillon të ngadalësohet me ritme të tilla që masat kufizuese mund të hiqen plotësisht deri në fund të qershorit dhe aktiviteti normal ekonomik të rifillojë në Gjashtëmuorin e dytë 2020.


¹¹Në skenarin negativ, supozohet se përhapja e pandemisë vijon me ritme të tilla që masat kufizuese nuk mund të hiqen deri në fund të gushtit.

¹²BB, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19 - Perspektiva e Ballkanit Perëndimor, Pranverë 2020, <http://documents1.worldbank.org/curated/en/606131588087679463/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Western-Balkans-Outlook.pdf>

¹³Ibid.

¹⁴BB, Perspektiva e Ballkanit Perëndimor: Kohët e Vështira Kërkojnë Ekonomizim të Mirë, Pranverë 2020, <http://pubdocs.worldbank.org/en/876501588143423927/RER-17-Outlook-ALB.pdf>

Figura 2: Zhvillimi rajonal i konsumit në Ballkanin Perëndimor i parashikuar në vitin 2020 sipas dy skenarëve




Burimi: Përlllogaritje të stafit të Bankës Botërore¹⁵

Shënim: Për Shqipërinë, skenari Para COVID-19 përfshin edhe efektet e tërmetit dhe rindërtimit.

Investimet, rënia e kërkesës agregate në vendet e BE-së si rezultat i krizës ekonomike dhe sociale nga pandemia COVID-19 në vitin 2020 në vendet e Ballkanit Perëndimor do të përcillet me rënie të investimeve (të brendshme dhe të huaja), sipas skenarit bazë do të jenë 5.3 përqind, ndërsa skenarit negativ 7.7 përqind. Ky vlerësim vë për shkak se BE është destinacioni i 94.9 përqind të eksporteve dhe burimi i 44 përqind të IHD-ve të

vendeve të rajonit. Referuar te dhënave të GBB nga vendet e rajonit, Kosova do të pësojë goditjen më të rëndë me një rënie prej 21.5 pikë përqindje (pp)¹⁶ sipas skenarit bazë dhe 28.5 pikë përqindje (pp) sipas skenarit negativ, për shkak të investimeve të vonuara publike dhe orientimit të remitancave në konsum dhe jo të orientuara në sektorin e ndërtimit dhe pronave të paluajtshme gjatë këtij viti (Figura 3).

Figura 3: Zhvillimi rajonal i investimeve në Ballkanin Perëndimor i parashikuar në vitin 2020 sipas dy skenarëve



Burimi: Përlllogaritje të stafit të Bankës Botërore¹⁷

Shënim: Për Shqipërinë, skenari Para COVID-19 përfshin edhe efektet e tërmetit dhe rindërtimit.

Eksporti (i mallrave dhe shërbimeve), niveli relativisht i ulët i porositjeve të reja të eksportit para krizës COVID-19, i kombinuar me ndalimet e eksportit që lidhen me pandeminë, të prodhimit të kufizuar dhe të reduktuar, mbylljet e shitjes me pakicë, kufizimet e lëvizjes së njerëzve, rezultojnë me një rënie të kërkesës së jashtme dhe të ndjeshme të eksporteve. Në skenarin e saj negativ


GBB për vendet e Ballkanit Perëndimor parashikon rënie të eksporti me 11.3 përqind, ndërsa skenari negativ 17.6 përqind në vitin 2020. Ky vlerësim vë për shkak se BE është partneri kryesor në eksport (68 përqind). (Figura 4)

¹⁵bid.
¹⁶bid.
¹⁷bid.

Eksporti i mallrave në vendet e Ballkanit Perëndimor do të ketë rënie më të madhe në Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë. Eksportet e mallrave në këto vende janë të lidhur me zinxhirët e vlerës në rang global dhe industrive të prodhimit të automobilave dhe pjesëve të këmbimit, ku kërkesa për këto mallra ka rënie shkak të ndryshimeve në sjelljen e konsumatorëve pas pandemisë.¹⁸

Eksporti i shërbimeve është gjithashtu mjaft i ndikuar nga situata pandemike. Ekonomitë e Shqipërisë, Malit të Zi dhe Kosovës varen në shkallë të lartë nga eksportet e shërbimeve, kryesisht turizmi dhe sipas parashikimeve për shkak të kufizimeve në transportin e udhëtarëve, por edhe për shkak të ndryshimeve në sjelljen konsumatorëve pas pandemisë, i bën këto vende më të ndjeshme ndaj ndikimit ekonomik të krizës krahasuar me vendet e tjera të rajonit.¹⁹

Figura 4: Zhvillimi rajonal i eksporteve në Ballkanin Perëndimor i parashikuar në vitin 2020 sipas dy skenarëve (i shprehur në përqindje)




Burimi: Përlogaritje të stafit të Bankës Botërore²⁰

Shënim: Për Shqipërinë, skenari Para COVID-19 përfshin edhe efektet e tërmetit dhe rindërtimit.

Importi, gjithashtu pritet të ngadalësohet në mënyrë të konsiderueshme, sipas skenarit bazë me 7.6 përqind dhe skenarit negativ me 10.9 përqind në vitin 2020. Ky vlerësim vërejt si pasojë e ndikimit të pandemisë në rënie të aktivitetit

ekonomik në ekonominë e vendeve të BE, i cili është partneri kryesor në import për vendet e rajonit (61 përqind) dhe rënies së kërkesës dhe konsumit personal në këto vende. (Figura 5)

Figura 5: Zhvillimi rajonal i importeve në Ballkanin Perëndimor i parashikuar në vitin 2020 sipas dy skenarëve (i shprehur në përqindje)



Burimi: Përlogaritje të stafit të Bankës Botërore²¹

Shënim: Për Shqipërinë, skenari Para COVID-19 përfshin edhe efektet e tërmetit dhe rindërtimit.

¹⁸BB, Parashtrim i Situatës: Vlerësim i gjendjes dhe ndjeshmërisë të Ekonomive të Ballkanit Perëndimor në përballen e tyre me COVID-19, 2020, <http://pubdocs.worldbank.org/en/254111588143425920/RER-17-Setting-the-Stage-ALB.pdf>
¹⁹Ibid.
²⁰Ibid.
²¹Ibid.

1.1. Ndikimi i COVID-19 në Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Ballkanin Perëndimor

Kontributet e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në ekonominë e Ballkanit Perëndimor (BP) kanë qenë relativisht të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, posaçërisht në sektorin e industrisë përpunuese, duke krijuar mijëra vende të reja të punës, dhe duke siguruar mbështetje për rritjen ekonomike, inovacion dhe përparim teknologjik. Gjatë vitit 2018 shtetet që kanë pasur numër më të madh të investitorëve të huaj sipas BPV janë: Mali i Zi me 8.8 përqind, Shqipëria dhe Serbia me 8 përqind²². Investimet e huaja në rajon vijnë kryesisht nga Shtetet Anëtare të BE-së (Austri, Gjermani, Greqi, Itali, Holandë dhe Slloveni) si dhe Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Federata Ruse.

Përkeqësimi i perspektivës të IHD në vendet e rajonit pritet të ketë ndikim me diferenca thelbësore sipas sektorëve, bazuar në strukturën ekonomike dhe dobësitë e tyre në periudhën e para krizës.

Spektori i prodhimit përbën pjesën më të madhe të rezervave të IHD-ve në Maqedoninë e Veriut (36 përqind të aksioneve të IHD-ve), Serbi (32 përqind), Bosnjë dhe Hercegovinë (28 përqind). Investitorët e BE-së kanë investuar në biznese të orientuara drejt eksportit në rajon për të shërbyer në tregjet e tyre të brendshme²³. Industria prodhuese po vuan për shkak të masave mbrojtëse të distancimit social të cilat shkaktojnë pengesa në prodhim, rënie të porosive dhe probleme në zinxhirin e furnizimit e cila gjithashtu ka pasur ndikim në rënien të IHD në këto vende të rajonit.

Spektori i turizmit, kontribuon drejtpërdrejt me mbi 10 përqind të BPV-së përgjithshme të Ballkanit Perëndimor duke mbështetur një numër të madh të vendeve të punës dhe industrive, duke llogaritur rreth 11.4 përqind e të punësuarve në Ballkanin Perëndimor (sipas Grupit të Ekspertëve të Turizmit (TEG))²⁴. Ky sektor parashihet të jetë një nga sektorët më të dëmtuar prej pasojave të COVID-19, për shkak të kufizimeve të udhëtimit, masave të distancës sociale dhe të anulimeve të rezervimeve. Kjo goditje ekonomike e turizmit do të ndikojë negativisht në vendet e punës dhe do të ketë efekte për sektorët e tjerë ndërlidhës, siç

është industria agro-ushqimore, gastronomia, etj²⁵.

Nga vendet e rajonit, në sektorin e turizmit goditen më të madhe nga pandemia e ka marrë Mali i Zi për dallim nga vendet tjera të rajonit gjatë sezonit të verës së rish ka mbyllur kufijtë me shtetet fqinje për shkak të shtimit të rasteve të të infektuarve me koronavirus. Personat që dëshirojnë të hynin në Mal të Zi u lejuan vetëm me vërtetim nga institucionet përkatëse, që dëshmohet se nuk ishin të infektuar me koronavirus. Të dhënat statistikore dëshmojnë se numri i turistëve krahasuar me një vit më parë ka shënuar rënie deri në 90 përqind.

Relativisht më të fortë janë sektorët thelbësorë si mjekësia, zinxhiri i furnizimit me ushqime, sektori publik si dhe sektorët ku mund të punohet online, siç janë shërbimet profesionale të lidhura me ekonominë dixhitale.

²²BB, Treguesit e zhvillimit botëror: Rrjedhat financiare globale private, 2018, <http://wdi.worldbank.org/table/6.9>

²³OBZHE, Konkurrenca në Evropën Juglindore: Një Shikim i Politikave, 2018, <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/9789264298576-en.pdf?expires=1600765057&id=id&accname=guest&checksum=2282B6E3EBD9215E5E4DB5480B765B11>

²⁴RCC, Tourism in the Western Balkans: Where and how in the times of the pandemic?, 2020, <https://www.rcc.int/news/629/tourism-in-the-western-balkans-where-and-how-in-the-times-of-the-pandemic>

²⁵RCC, BREGU: Tourism in the Western Balkans already feels the pinch of COVID-19 pandemic, 2020, <https://www.rcc.int/news/618/bregu-tourism-in-the-western-balkans-already-feels-the-pinch-of-covid-19-pandemic>

2. Vështrim i Përgjithshëm i Ndikimit të COVID-19 në Kosovë

Grupi i Bankës Botërore (GBB) para pandemisë ka parashikuar që ekonomia e Kosovës të rritej me rreth 4.1 përqind në vitin 2020²⁶; mirëpo si pasojë e krizës ekonomike dhe sociale të shkaktuar nga pandemia COVID-19, në skenarin e saj fillestar, u

parashikua që BPV të bie deri 4.5 përqind gjatë vitit 2020, ndërsa në skenarin e saj negativ GBB supozon rënien e BPV për 11.3 përqind dhe recession të thellë në Kosovë, për më shumë shiko Tabelën 1.

Tabela 1: Parashikimi për Kosovën 2020 (para dhe pas COVID-19)

Kosova	2018	2019	2020		
			Para COVID-19	Pas COVID-19 Skenari Fillestar	Pas COVID-19 Skenari Negativ
			Parashikimet		
Rritja e BPV-së reale (në përqindje)	3.8	4.2	4.1	-4.5	-11.3
Konsumi	5.4	2.3	3.2	1.1	-0.6
Investimet	2.1	1.7	3.8	-21.5	-28.5
Eksportet	1.0	2.8	4.0	-12.2	-25.5
Importet	4.8	2.5	2.2	-6.8	-8.0

Burimi: Përlllogaritje të stafit të Bankës Botërore²⁷

Shënim: Për Kosovën, rritja reale e BPV është mesatarja e ponderuar.

Përkeqësimi i perspektivës së rritjes ekonomike ka çuar në një rënie të theksuar jo vetëm të BPV, por dhe pritet të ketë ndikim negativ edhe në treguesit tjerë ekonomik, si: konsum; investime; import dhe eksport.

Konsumi, në ekonominë e vendit vlerësohet të kenë qenë ndër treguesit kryesor të rritjes ekonomike (sidomos në vitin 2018 rreth 5.4 përqind e BPV). Rritja e konsumit privat ishte rezultat i: përmirësimit të kushteve kredituese (rritjes së kredive për konsum); rritjes së importit të mallrave për konsum; rritjes së dërgesave nga emigrantët (remitancave)²⁸. Ndërsa rritja e konsumit publik ishte rezultat i rritjes së shpenzimeve të qeverisë për: mallra dhe shërbime; paga dhe mëditje; si dhe subvencione dhe transfere, duke kontribuar gjithashtu në mënyrë indirekte në rritjen e konsumit privat. Shiko tabelën 1.

Konsumi sipas skenarit bazë të GBB pritet të bie për 1.1 përqind, ndërsa sipas skenarit negativ 0.6

përqind. Faktorë kryesorë në rënien e konsumit janë: rritja e papunësisë dhe rënia e aktiviteteve ekonomike të bizneseve, ku blerjet e qytetarëve sidomos në muajt mars dhe prill ishin të orientuara vetëm në produkte esenciale. Ndërkaq edhe pse BB dhe BQK kishte paralajmëruar rënie të remitancave me 4.7 përqind, në realitet ka ndodhur e kundërta. Bazuar në të dhënat e BQK-së, për gjashtë muajt e parë të vitit 2020, mërgata ka dërguar 27.8 milionë euro më shumë se sa e njëjta periudhë e vitit të kaluar (për sa i përket dërgesave të mërgatës për gjashtë muaj ka sjellë 433.2 milionë euro në Kosovë)²⁹. Ndërsa konsumi qeveritar pritet të rritet ndjeshëm bazuar në projeksionet buxhetore për shkak të përgjigjes së nevojshme ndaj COVID-19.

Investimet, gjatë dy viteve të fundit (2018 dhe 2019) vlerësohet të kenë qenë rreth 2.1 përqind e BPV, të cilat i atribuohen rritjes së investimeve publike dhe atyre private. Investime publike gjate këtyre dy viteve mbeten në terma nominal. Ndërkaq rritja e investimeve private ishte për shkak të rritjes së kredive të reja investuese dhe investimeve në sektorin e ndërtimitarisë dhe paluajtshmërisë. Në të njëjtën kohë, një tjetër shtytës

²⁶Kryesisht rritja ekonomike ka qenë e mbështetur te konsumi, remitancat dhe importet dhe jo te prodhimi, investimet dhe eksportet; ka qenë më shumë me natyrë sasiore ekstensive, sesa një rritje ekonomike cilësore, që buron nga sektorë e aktivitete me efikasitet të lartë dhe teknologji e inovacione moderne.

²⁷BB, Ballkani Perëndimor RrE - KOSOVA, 2020, <http://pubdocs.worldbank.org/en/879051588144489517/RER-17-Kosovo-Country-Note-AL-B.pdf>

²⁸Remitancat në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme sipas viteve referuar të dhënave të BQK-së: vitin 2017(759.2mil euro) vitin 2019(800.5mil euro) dhe vitin 2019 (851.5 mile euro)

²⁹Për sa i përket dërgesave të mërgatës sipas vendeve, Gjermania është shteti ku më së shumti dërgohen para në drejtim të Kosovës, e ndjekur nga Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës

në rritjen e investimeve është edhe përmirësimi i ambientit të të bërit biznes, i cili reflekton edhe në rezultatet e Raportit të të Bërit Biznes të Bankës Botërore 2019 (shiko Tabelën 1).

Investimet në vitin 2020, sipas skenarit bazë të GBB priten të bien për 21.5 përqind, ndërsa skenarit negativ 28.5 përqind e cila vie për shkak të zvogëlimit investimeve publike të financuara nga buxheti i Kosovës për t'iu përgjigjur kërkesave të pandemisë për zbutjen e efekteve negative në ekonomi të COVID -19³⁰. Disa projekte të mëdha të investimeve publike që pritej të përparonin, veçanërisht projektet hekurudhore dhe rrugore të financuara nga institucionet financiare ndërkom-bëtar mund të vonohen³¹. Gjithashtu investimet kapitale që prekin komunat, janë pezulluar rreth 10 milionë euro investime të reja nga ministritë³². Investimet private, në anën tjetër, pritet të ulen nga pasiguria e bizneseve për të investuar dhe kufizimet e tyre në likuiditet, si dhe rënien e kërkesës së diasporës për të blerë prona të paluajtshme. Rritja pritet të rikthehet në vitin 2021, pas tkurrjes së vitit 2020.

Eksporti, ka pasur rritje në vitin 2019 falë riaktivizimit të Ferronikelit dhe rritjes solide të eksporteve të shërbimeve nga turizmi i diasporës (80 përqind lidhen me udhëtimet, vizitat nga diaspora në Kosovë). Sipas Agjencisë Kombëtare të Statistikave (ASK), në 2019 eksportet kryesore të Kosovës ishin makineri, pajisje mekanike dhe elektrike; plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; artikuj prej guri, allçie, produkte qeramike dhe qelqi; produkte të industrisë kimike, tekstil dhe artikuj tekstili; metale bazë dhe artikuj prej tyre; ushqime të përgatitura, pije, pije alkoolike dhe duhan; druri dhe artikuj druri.³³

Kosova në vitin 2019 ka tregtuar kryesisht me fqinjët e saj, me vendet e CEFTA-s që marrin 164,8 milion euro ose 43.0 përqind të eksporteve të saj në fund të vitit 2019 (Shqipëria 17.6 përqind, Maqedonia 11.5 përqind, Serbia 7.1 përqind dhe Mali i zi 5.1 përqind). BE-ja përbënte 138,5 milion euro ose 36.1 përqind të eksporteve totale, kryesisht drejt Gjermanisë 8.1 përqind, Italisë 5.9 përqind, Holandës 4.3 përqind, dhe Britanisë së Madhe 2.9 përqind). Ndërsa eksportet me vendet e tjera të botës arritën vlerën në 80,1 milion euro

ose 20.9përqind, ku partner më të rëndësishëm nga këto vendet për eksport ishin: India (8.6përqind), Zvicra (7.4përqind).³⁴

Sipas GBB, për shkak të pandemisë COVID-19 eksporti pritet të zbres nga rritja e përgjithshme për 12.2 përqind sipas skenarit bazë, ndërsa sipas skenarit negativ eksportet pritet të bien në terma real për 28.5, kryesisht për shkak të rënies së thellë nominale të eksporteve të shërbimeve (25.9 përqind) dhe mallrave (18.6 përqind). Jo vetëm për shkak të eksporteve më të ulëta të shërbimeve, por edhe për shkak të rënies së parashikuar të çmimeve të nikelit.

Ndërsa sipas të dhënave nga Tregtia e Jashtme e Mallrave në Kosovë sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për (-18.2 përqind) në muajin gusht 2020, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019, gjegjësisht në vlerë prej 228.9 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 279.9 milionë eurosh në vitin 2019. Eksporti mbulon importin me 13.0 përqind. Megjithatë kjo rënie është më e vogël krahasuar me muajin prill 2020, ku rënia ishte për (-37.6) në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2019, për shkak të kufizimeve të shumta nga ana e qeverisë së Kosovës dhe vende tjera të BE-së, për parandalimin e pandemisë COVID-19. (Tabela 2)

³⁰Në bazë të kategorive ekonomike vërejmë së në periudhën prej fillimit të pandemisë investimet kapitale janë përgjysmuar nga 71.5 milionë euro sa ishin në periudhën mars-maj 2019 në 34.8 milionë euro në vitin 2020.

³¹Ibid.

³²Ndër projektet kryesore që ishin paraparë të realizohen nga MIA në komunat e Kosovës dhe që janë pezulluar janë ndërtimi i impianteve në komunat e Gjilanit (1 milion euro) dhe Ferizajt (500 mijë euro), zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Vushtrri (750 mijë euro), ndërtimi i shtëpive në pjesën veriore të Kosovës (500 mijë euro), dhe më shumë. Kurse, tek projektet e MKRS, projektet kryesore të pezulluara janë Ndërtimi i Qendrës Nacionale të Tenisit të Kosovës në Prishtinë (200 mijë euro) dhe Rivalizimi i stadiumit në Pozheran në Viti (200 mijë euro). Nga projektet e MASHT do të preken ndërtimi i shkollës "Fan Noli" në Kamenicë (200 mijë euro) dhe ndërtimi i shkollës në Damjan në Gjakovë (169 mijë euro).

³³Societe Generale, Country Risk of Kosovo: International Trade, Korrik 2020, <https://import-export.societegenerale.fr/en/country/kosovo/trade-country-risk>

³⁴ASK, Statistikat e Tregtisë së Jashtme, 2019, <https://ask.rks-gov.net/media/5451/tregtija-e-jashtme-vjetore-2019.pdf>

Tabela 2: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme (Janar- Gusht viti 2019, 2020) i shprehur në Euro

	Eksporti		Importi		Balanci tregtar	
Muajt:	Viti (2019)	Viti (2020)	Viti (2019)	Viti (2020)	Viti (2019)	Viti (2020)
Janar	23,480	28,939	190,442	221,216	-166,962	-192,277
Shkurt	24,050	35,933	232,701	263,392	-208,651	-227,459
Mars	29,572	32,164	289,192	252,070	-259,620	-219,905
Prill	36,940	32,688	295,496	193,974	-258,556	-161,285
Maj	31,891	38,766	321,619	239,079	-289,728	-200,313
Qershor	32,115	44,627	275,202	290,804	-243,087	-246,177
Korrik	40,464	42,636	336,878	306,377	-296,414	-263,741
Gusht	31,906	34,317	311,857	263,305	-279,952	-228,987

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, sipas muajve Janar-Gusht 2020

Importi, sipas parashikimeve të GBB do të bie për 6.8 përqind sipas skenarit bazë, ndërsa skenarit negativ me 8 përqind në vitin 2020 në Kosovë.

Gjithashtu referuar të dhënave nga Tregtia e Jashtme e Mallrave në Kosovë sipas ASK-së, prej muajit mars deri në muajin gusht ka rënie të vazhdueshme të importit me përjashtim të muajit qershor, e cila ka ndikim në rënien e të hyrave doganore³⁵. Kosova është e varur nga importi i produkteve të huaja, qoftë nga rajoni apo nga vendet e Bashkimit Evropian, pasi industria e prodhimit vendor ende mbetet pak e zhvilluar.

Sipas ASK, nga ana e importeve në vitin 2019, BE furnizoi 50.0 përqind të importeve totale të Kosovës (Gjermania 12.8 përqind, Italia 6.4 përqind, Greqia 5.6 përqind, Sllovenia 3.8 përqind dhe Bullgari 3.5 përqind, etj.). Importet nga CEFTA ishin 14.4 përqind (Maqedonia 6.9 përqind, Shqipëria 6.4 përqind, Mali i zi 0.8 përqind dhe Serbia 0.2 përqind); ndërsa importet e Kosovës me vendet tjera arritën në 35.6 përqind, ku me pjesëmarrje me të lartë në këtë grup janë: Turqia (12.3 përqind) dhe Kina (9.7 përqind).³⁶

Kosova ka një treg të vogël të brendshëm dhe prodhimtari të kufizuar industriale, dhe importet e saj mbeten më të larta se eksportet. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, deficitit tregtar i Kosovës vazhdoi të zgjerohet në 2018 në 3.1 miliardë euro, nga 2.97 miliardë euro një vit më parë, me importe që u rritën në 3.5 miliardë euro, nga 3.34 miliardë euro, ndërsa eksportet u rritën me 4.4 përqind krahasuar me vitin e kaluar, në

383.4 milion euro, nga 367 milion euro një vit më parë.

2.1. Ndikimi i COVID-19 në Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në Kosovë

Përkundër trendit pozitiv të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në vitin 2019 (një rritje e vogël) në krahasim me vitin 2018, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), IHD-të pësuan rënie të konsiderueshme gjatë vitit 2018 dhe 2017, duke lënë Kosovën si një vend jo tërheqës për investime të huaja dhe larg tërheqjes së investimeve nga korporatat dhe markat e mëdha botërore. Rritja e IHD-ve u evidentua kryesisht në sektorin e pasurive të paluajtshme, sektorin e minierave, energji elektrike dhe tregti, ndërsa shërbimet financiare dhe sektori i ndërtimeve shënuan rënie.

Nëse krahasojmë investimet e huaja sipas shteteve, Gjermania, Zvicra, Britania e Madhe, Turqia, Austria dhe Shqipëria, këto shtete nder vite kanë dhënë një kontribut të madh sa i përket IHD-ve në Kosovë. Në Tabelën 3 janë paraqitur shumtë e investuara nga këto shtetet, ku me një diferencë mjaft të madhe me shtetet e tjera prin Gjermania me 715.03 milion euro investime të hyra që nga viti 2007, duke u cilësuar investuesi më i madh në Kosovë. (Tabela 3)

³⁵Dogana e Kosovës kontribuonë më së shumti në mbushjen e buxhetit të Kosovës. Sipas parashikimeve para COVID-19 buxheti i Kosovës për vitin 2020 është parashikuar të jetë 2,3 miliardë euro. Sipas këtij buxheti, Doganat e Kosovës për arken e shtetit do të duhet të grumbullojnë mbi 1,2 miliardë euro, ndërsa nga Administrata Tatimore e Kosovës rreth 600 milionë euro.

³⁶ibid.

Tabela 3: IHD-të në Kosovë sipas shteteve (për periudhën 2007 - Qershor 2020)

IHD sipas Shteteve 2007 - Qershor 2020	
Shteti	Shuma e Investuar
Gjermania	715.03 mil €
Zvicra	593.70 mil €
Britania e Madhe	388.12 mil €
Turqia	374.23 mil €
Austria	283.09 mil €
Shqipëria	281.62 mil €

Burimi: KIESA, 2020 (nga përgjigjet e anketës së realizuar)

Për të analizuar ndikimin e pandemisë COVID-19, në investime të huaja direkte në Kosovë, në vazhdim kemi krahasuar të dhënat e vitit 2019 dhe 2020 në periudhën e gjashtëmujorit të parë (tremujorin e parë T1 dhe tremujorin e dytë T2), duke ju referuar statistikave të publikuara nga BQK. Nga të dhënat mund të vërehet se edhe në tremujorin e parë dhe të dytë kemi pasur një rritje

të investimeve të huaja në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019. Në T1, kemi rritje prej 34.5 milion euro, ndërkaq në T2 kemi 28.2 milion euro. Në Tabelën 4, gjithashtu mund të shihet vlera e investimeve të huaja sipas sektorëve të shprehura në milion, ku Patundshmëria, Qiradhënia dhe aktivitetet tjera biznesore vazhdimisht ndër vite prijnë IHD-të në Kosovë.

Tabela 4: Vlera e IHD-ve në Kosovë - sipas aktivitetit ekonomik për periudhën Janar – Korrik 2019 dhe Janar - Korrik 2020 (të shprehura në milion euro)

Periudha kohore	2019			2020		
	T1	T2	Korrik	T1	T2	Korrik
Gjithsej	70.0	40.8	36.9	104.5	69.0	29.1
Bujqësia	0.1	0.8	0.1	1.2	0.9	0.1
Minierat	-5.8	-1.3	0.6	9.7	11.7	1.5
Industria	2.3	-1.8	3.3	-3.0	4.5	0.2
Energjetika	2.7	2.7	1.4	24.6	-2.3	-1.0
Ndërtimi	15.4	-6.1	-0.6	-3.4	1.5	5.0
Shërbime tregtare	-2.5	-4.4	0.0	-3.9	1.5	0.7
Hotele dhe Restorante	0.6	0.2	0.1	0.2	0.7	0.1
Transporti dhe komunikimi	-4.3	4.2	1.5	5.0	-13.1	0.3
Shërbime financiare	16.4	-12.8	10.5	19.8	30.6	4.1
Patundshmëria, qiradhënia dhe aktivitetet tjera biznesore	44.1	54.2	19.3	51.3	32.2	17.1
Shërbime tjera*	0.7	0.9	0.4	1.9	0.5	0.3
Aktivitetet tjera të pa klasifikuara diku tjetër	0.4	4.2	0.2	1.1	0.5	0.7

* Shërbime të tjera: arsim, shëndetësi dhe punë sociale, shërbime sociale dhe personale.

Burimi: BQK, Buletini Mujor Statistikor (Gusht 2020)

Për shkak të rëndësisë në mirëqenien e një numri të madh të qytetarëve të Kosovës, por edhe në financimin e ekonomisë përmes stimulimit të konsumit dhe investimeve private si dhe për ekonominë e vendit në tërësi, pjesë e këtij studimi janë gjithashtu ndikimi i COVID-19 në dërgesat e emigrantëve (remitancat). Sipas parashikimeve të Grupit të Bankës Botërore parashihej rënie e rem-

itancave me rreth 4.7 përqind, për shkak të rënies së aktivitetit ekonomik në shumë vende që ka më shumë emigrantë nga Kosova, mirëpo kjo gjë nuk ka ndodhur. Pavarësisht pandemisë COVID-19, mërgata e Kosovës e ka thyer rekordin e dërgesave të parave në vendin tonë. Rritje të remitancave kemi në dy tremujoret, gjithashtu edhe në muajin Korrik 2020³⁷ (Tabela 5)

Tabela 5: Dërgesat e emigrantëve - sipas kanaleve të dërgimit për periudhën Janar – Korrik 2019 dhe Janar - Korrik 2020 (të shprehura në milion euro)

Periudha kohore	Gjithsej	Bankat komerciale	Agjencitë për transferimin e parave	Të tjera
2019				
T1	184.9	23.7	94.2	67.0
T2	220.7	26.9	113.8	80.0
Korrik	73.9	15.7	31.5	26.8
2020				
T1	187.3	23.3	105.3	58.7
T2	247.2	36.8	199.0	11.3
Korrik	92.3	15.0	69.3	8.1

Burimi: BQK, Buletini Mujor Statistikor (Gusht 2020)

Sipas zyrtarëve të KIESA, është me rëndësi të theksohet që gjatë këtyre muajve edhe pse investitorët aktual kanë hasur në mjaft vështirësi nga kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19, nuk është shënuar ndonjë rast ku investitorët janë tërhequr apo i kanë mbyllur filialet e tyre në Kosovë. Sipas zyrtarëve të KIESA-së dhe KIE-së është e nevojshme përfshirja dhe ndihma e qeverisë për investitorët aktual në Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike. Sipas KIE, gjithashtu institucionet tona është dashur të punojnë më shumë në këtë drejtim, të bashkëpunojnë më shumë me institucionet financiare prezentë në vendin tonë, në mënyrë që ti artikulojnë nevojat së bashku dhe ti adresojnë në një mënyrë me efektive. Problemi nuk qëndron vetëm tek vlera monetare e parashikuar, por edhe tek vonesat në implementimin e kësaj pakoje. Sipas KIE, nëse nuk miratohet dhe nuk fillon të implementohet shpejt ligji për Rimëkëmbjen Ekonomike një numër i vogël i IHD-ve do të kenë të vështirë të mbijetojnë, për shkak të: pasigurisë, rënies së fitimit e cila mund të reflektohet në gjashtëmujorin e dytë të këtij viti.

Shpresëdhënëse për Kosovën janë interesimet për prurje të investimeve të reja, të cilat edhe gjatë këtij viti nuk kanë munguar sipas zyrtarëve të KIESA. Më shumë kanë shprehur interes për të investuar në sektorin e energjisë, në Burimet e

Ripërtrithme (BRE), Energji Efiçiente (EE), turizëm, dhe në bujqësi, të cilët njëherit janë edhe sektor me prioritet sipas Ligjit për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës.

³⁷Ibid.

3. Përfundime dhe Rekomandime

Aplikimi i masave kufizuese me qëllim të parandalimit dhe ngadalësimit të përhapjes së virusit ka goditur fuqishëm ekonominë e çdo vendi, duke ndikuar negativisht në gjithë treguesit ekonomik përfshirë edhe IHD-të. Institucionet prestigjioze ndërkombëtare si Banka Botërore dhe FMN, kanë korigjuar projeksionet e tyre fillestare duke mbështetur më shumë parashikimet e recesionit ekonomik sipas skenarit negativ. Një situatë e tillë po vërehet edhe në Kosovë, ku pothuajse të gjithë treguesit ekonomik kanë shënuar rënie (me përjashtim të rritjes së remitancave për 5 përqind).

Instituti IETL vlerëson se Qeveria e Republikës së Kosovës (QeK) duhet të shtyjë sa më parë strategjinë kombëtare pesëvjeçare të zhvillimit dhe rimëkëmbjes ekonomike, në të cilën duhet të ketë gjithashtu plan konkret për stimulimin e investimeve të huaja të cilat pësojnë rënie të konsiderueshme gjatë vitit 2018 dhe 2017, duke lënë Kosovën si një vend jo tërheqës për investime të huaja dhe larg tërheqjes së investimeve nga korporatat dhe markat e mëdha botërore. Duhet të kemi objektivat të qarta zhvillimore dhe model të rritjes ekonomike të përgatitur me konsensus politik e shkencor të nevojshëm dhe të respektuar nga i gjithë spektri politik.

Në vazhdim IETL ka paraqitur disa rekomandime për qeverinë dhe institucionet tjera relevante për tejkalimin e krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia dhe rekomandime për te tejkalimin e pengesave tjera para pandemisë të cilat janë pengesa të vazhdueshme për të bërë biznes në Kosovë (niveli i ulët i besueshmërisë institucionale, pengesat fiskale, pengesat administrative, korrupsioni, ekonomia joformale, energjia elektrike) dhe kërcënojnë vazhdimisht mjedisin e biznesit për tërheqjen e IHD në Kosovë nga shpallja e pavarësisë.

- **Rritja e aftësive digjitale tek të rinjtë.** Sipas vlerësimit të organizatës ndërkombëtare të punës (ILO), pandemia është duke shkaktuar një tronditje të trefishtë tek të rinjtë dhe në veçanti tek gratë e reja. Edhe në Kosovë pasojat e pandemisë pritet të godasin të rinjtë më ashpër se grup moshat e tjera³⁸ (për arsye se të rinjtë tanë punojnë më shumë në sektorë që karakterizohen me informalitet më të lartë). Në anën tjetër, pandemia ka demonstruar rëndësinë e rritjes së teknologjisë dixhitale në të

gjithë botën për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive krizës ekonomike. Për rrjedhojë, periudha e pas pandemisë mund të jetë një fillim i ri për shumë politika publike në sferën e punësimit³⁹. Nga ky këndvështrim, stimulimi i rritjes së aftësive digjitale për të rinjtë e Kosovës duhet të jetë fokus i politikave publike e cila do të siguroj zhvillim ekonomik të të qëndrueshëm afatgjatë dhe atraktiv për Investime të Huaja Direkte në Kosovë.

- **Mundësia e përsheptimit të transformimit dixhital.** Ndërmarrjet të cilat gjatë këtyre muajve të pandemisë kanë funksionuar përmes shitjeve online apo e-commerce, i kanë mbijetuar më mirë krizës së pandemisë. Në mes të kësaj krize ekonomike, Kosova ka një mundësi të paprecedentë që të riformoj strukturën e saj ekonomike dhe të përsheptojë ndryshimet në çështje të rëndësishme ekonomike dhe sociale, të cilat deri më tani kanë minuar përparimin ekonomik të vendit. Padyshim se rruga përpara varet shumë nga masat e guximshme që qeveria do të jetë e gatshme dhe e vullnetshme t'i marrë. Në ekonominë e zhvilluara mirë dhe ato në zhvillim, intervenimi i qeverisë ka qenë mjaft mbresëlënëse, e Kosova duhet të ndjekë të njëjtën rrugë. Qeveria duhet të shikoj mundësinë e inkurajimit të ndërmarrjeve përmes trajnimeve për transformimin dixhital për tregti elektronike duke shfrytëzuar dixhitalizimin në luftën kundër COVID-19, si dhe për të lehtësuar hyrjen e tyre në tregje të reja. Përmirësimi edhe më tej i infrastrukturës dhe aftësive dixhitale do kontribuojë në stabilitetin ekonomik të vendit dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

- **Hendeku i shkathtësive ndërmjet arsim-it/trajnimit dhe nevojave të tregut të punës.** Referuar gjetjeve të anketës së realizuar nga Instituti IETL me ndërmarrje të regjistruara në Kosovë me pjesëmarrje të kapitalit të huaj⁴⁰, është shqetësues fakti që shumë investitorë në Kosovë, flasin për probleme të mëdha për gjetjen e punëtorëve me shkathtësi adekuate në sektor të ndryshëm të ekonomisë. Kjo tregon që problemi i hendekut të shkathtësive duhet të konsiderohet me prioritet nga qeveria, duke harmonizuar vazhdimisht programet e arsimit me kërkesat e tregut të punës.

- **Rritja e stimulimeve nga ana e qeverisë për**

³⁸Situata tek të rinjtë është veçanërisht shqetësuese. Sipas ASK-së, në nivel të Kosovës, tek të rinjtë, nga 15-24 vjeç, shkalla e punësimit është rreth 14.4 përqind (19.4 përqind për burra, dhe 8.6 përqind për gratë). Për ata në grup moshën 25-34 vjeç, shkalla e përgjithshme e punësimit është 36.6 përqind).

³⁹Referencë nga Raporti i Investimeve Botërore, edicioni i 30-të, 2020, (rekomandime për vendet në zhvillim) shiko https://unctad.org/en/PublicationsLibrary/wir2020_en.pdf
⁴⁰<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf>

tërheqjen e investimeve të huaja. Qeveria e Kosovës duhet të punojë në përpilimin e një plani konkret dhe konkurrues me vendet e rajonit për tërheqjen e investimeve të huaja, duke i dhënë rëndësi disa stimulimeve si: a) futjen e pushimeve tatimore, b) rritjen e investimeve infrastrukturore në zonat e lira ekonomike dhe doganore, c) krijimin e hapësirave për parqet e biznesit, d) krijimin e paketave për të mbuluar shpenzimet e trajnimit për kompanitë që punësojnë numër të madh të punëtorëve, e) mbulimin i një përqindjeje të caktuar të pagave të punonjësve për t'i dhënë hov punësimit. Planit duhet të jetë me prioritet dhe pjesë e strategjisë për rimëkëmbje ekonomike.

- **Përmirësimi i infrastrukturës.** Në infrastrukturë, furnizimi i pamjaftueshëm dhe i paqëndrueshëm i energjisë elektrike është ende një pengesë e madhe. Në shumë raste, bizneset e huaja dhe vendore edhe në vitet e kaluara edhe gjatë kësaj periudhe të pandemisë janë përballuar me probleme të energjisë elektrike duke shkaktuar dëme të mëdha në bizneset e tyre. Të gjitha këto duhet të trajtohen me përparësi. Ndërkaq krahasuar me furnizimin me energji elektrike, lidhjet e pazhvilluara të transportit (hekurudhor) konsiderohen si pengesë më pak e detyrueshme, mirëpo të rëndësishme për lehtësimin e qarkullimit tregtar dhe tërheqjen e investimeve të huaja.
- **Reformat e thella strukturore.** Në mënyrë që rikuperimi ekonomik të jetë sa më i qëndrueshëm në periudhë afatmesme dhe afatgjatë, qeveria e Kosovës duhet të punojë në reformat të thella strukturore për të transformuar ekonominë, për të përmirësuar konkurrueshmërinë, për të tërhequr investime dhe për të rritur prodhimtarinë me qëllim rritjen e produktivitetit.
- **Përmirësimi i sundimit të ligjit dhe zbatimi i kontratave.** Edhe përkundër faktit se në Treguesit e Bankës Botërore për Qeverisje janë shënuar disa përmirësime marginale në zbatimin e kontratave dhe në sundimin e ligjit në përgjithësi, ende sipas anketës së realizuar nga Institutit IETL me ndërmarrje të regjistruara në Kosovë me pjesëmarrje të kapitalit të huaj⁴¹, një nga sfidat më kritike është përmbartimi i kontratave në gjykatat e Kosovës. Ky tregues paraqet barrë të madhe për bizneset në përgjithësi e veçanërisht, për bizneset e huaja që vijnë dhe investojnë në Kosovë, me perceptimin se ata do të gjejnë një mjedis miqësor, ku të drejtat e tyre do të mbrohen dhe respektohen.

Është nevojshme që të themelohet një gjykatë komerciale për t'i trajtuar çështjet e tilla gjyqësore ku merren vendime të drejta, transparente dhe me kohë.

- **Mjedisi biznesor dhe ulja e ekonomisë jo-formale.** Kosova viteve të fundit edhe pse ka shënuar progres në indikatorët që masin mjedisin e të bërit biznes si ata të Raportit të të Bërit Biznes të Bankës Botërore dhe në Aktin e Biznesit të Vogël të Komisionit Evropian, ende ekonomia jo formale, korrupsioni dhe format tjera të ekonomisë së zezë mbeten një problem i madh në Kosovë, duke ndikuar në çrregullimin e tregut të punës, konkurrencës jo të drejtë dhe pengesë e madhe për tërheqjen e IHD. Për këtë arsye Qeveria e duhet ta konsideroj me prioritet zhvillimin e një plani të veprimi të besueshëm antievazion.
- **Orientimi i remitancave në investime.** Remitancat edhe gjatë periudhës së pandemisë vazhduan të jenë një burim i rëndësishëm për familjet kosovare dhe për ekonominë e vendit. Mirëpo shfrytëzimi i tyre edhe këtë vit sikurse në vitet e kaluara u përdor kryesisht për të financuar konsumin e jo për investime të cilat do të kishin efekt në zhvillim ekonomik afatgjatë. Për fat të keq, deri më sot, nuk ka pasur nisma, as nga institucionet ose nga shoqata të ndryshme biznesi që remitancat të orientohen në investime. Qeveria e Kosovës duhet të marrë masa për të krijuar politika të përshtatshme për investimin e remitancave në biznese, të cilat do të krijojnë vende të reja pune dhe do të rrisin zhvillimin ekonomik afatgjatë dhe IHD në Kosovë.
- **Kosova duhet të përfitojë nga pozita e vet qendrore në rajon.** Të gjitha vendet e rajonit ngelin shumë prapa në krahasim me vendet e Evropës Qendrore (EQ) sa i përket IHD-ve. Prandaj tërheqja e investitorëve serioz në secilin prej vendeve të rajonit domosdo përmban dimensionin rajonal. Qeveria e Kosovës duhet të shikojë mundësitë për të përfituar nga pozita e vet qendrore në rajon, duke e materializuar atë më tërheqjen e investimeve që gravitojnë në tregun rajonal dhe më gjerë. Gjithashtu njohja e realitetit të Kosovës nga ana e Serbisë është një hap tjetër përpara që nxit më tej bashkëpunim më të ngushtë dhe integrimin rajonal të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

⁴¹<https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf>

4. Literatura

- Intervista e realizuar me z. Kreshnik Thaqi - Udhëheqës i Sektorit për Promovim të Investimeve në Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA).
- Intervista e realizuar me z. Emrush Ujkani - Drejtor Ekzekutiv në Këshillin e Investitorëve të Evropës (KIE).
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e Tregtisë së Jashtme, 2019.
- Banka Qendrore e Kosovës, 2020.
- Banka Botërore, Ndikimi Ekonomik dhe Social i COVID-19 - Perspektiva e Ballkanit Perëndimor, <http://documents1.worldbank.org/curated/en/606131588087679463/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Western-Balkans-Outlook.pdf>, Pranverë 2020.
- Banka Botërore, Perspektiva e Ballkanit Perëndimor: Kohët e Vështira Kërkojnë Ekonomizim të Mirë, <http://pubdocs.worldbank.org/en/876501588143423927/RER-17-Outlook-ALB.pdf>, Pranverë 2020.
- Banka Botërore, Treguesit e Zhvillimit Botëror: Rrjedhat Financiare Globale Private, <http://wdi.worldbank.org/table/6.9>, 2018.
- Eurostat, Vendet e Ballkanit Perëndimor- BE-statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave, https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Western_Balkans-EU_-_international_trade_in_goods_statistics&oldid=479958#The_Western_Balkans_trade_with_the_EU_and_other_main_partners, 2019.
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Qershor 2020.
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), Kriza e COVID-19 në Kosovë, Qershor, 2020.
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), Konkurrenca në Evropën Juglindore: Një Vështrim i Politikave, 2018.
- Organizata Botërore e Shëndetësisë, Sëmundja e Koronavirus (COVID-19), <https://covid19.who.int/>, 2020.
- Instituti për Ekonomi të Tregut të Lirë, INVESTIMET E HUAJA DIREKTE NË KOSOVË, Klima e investimeve, potenciali dhe barrierat, <https://ietl-oek.com/wp-content/uploads/2020/09/19-12-24-Foreign-Direct-Investment-in-Kosovo-The-InvestmentClimate-Potential-and-Barriers-ALB.pdf>, Dhjetor 2019.
- Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), Shtator 2020.
- Societe Generale, Rreziqet e Shtetit: Kosova, <https://import-export.societegenerale.fr/en/country/kosovo/economy-country-risk>, Korrik 2020.